



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 544 Prot.

Roskovec, më 01.07 2025

VENDIM

NR. 33, DATË 30.06.2025

PËR

DHËNIEN E TITULLIT "QYTETAR NDERI" TË BASHKISË ROSKOVEC

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, përkatësisht nenit 9 pika 1.7, gërma a), nenit 54 pika m); të Ligjit nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", nenit 8, nenit 9 pika 1, nenit 11 pika 2, nenit 13; si dhe të VKM-së nr. 861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë"; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Miratimin për Dhënien e Titullit "Qytetar Nderi" të Bashkisë Roskovec, si më poshtë:
 - a. **Tofik Kasëm Kodheli** me motivacionin: *"Për veprimtarinë e tij në Luftën Nacionalçlirimtare dhe drejtimin e kooperativës së parë bujqësore në zonë; i njohur për përkushtimin e palodhur ndaj komunitetit dhe rolin edukues në formimin e brezave të rinj"*.
 - b. **Naun Stefan Baba** me motivacionin: *"Për kontributin si veteran i Brigadës së 7 Sulmuese dhe angazhimin e çmuar në zhvillimin ekonomik e shoqëror të Roskovecit pas Luftës; i dekoruar me urdhra dhe medalje për merita në punë"*.
 - c. **Marko Uani Preçe** me motivacionin: *"Për shërbimin e ndershëm dhe përkushtimin shumëvjeçar si administrues në gjendjen civile; i njohur për korrektesën, ndihmën ndaj qytetarëve dhe integritetin në ushtrimin e detyrës"*.
 - d. **Alush Sali Metohu** me motivacionin: *"Për drejtimin e suksesshëm në sektorin bujqësor dhe industrial, si dhe për angazhimin e tij të vazhdueshëm si aktivist në mbrojtje të të drejtave të emigrantëve shqiptarë në Greqi"*
 - e. **Shahin Halit Satëri** me motivacionin: *"Për kontributin e tij të spikatur si punëtor dhe drejtues në sektorët bujqësor dhe ndërtimor; me një karrierë të gjatë si funksionar e kryetar fshati në komunitetin e Luarit, i dalluar për ndershmëri, përkushtim dhe shërbim ndaj qytetarëve"*.

2. Ngarkohet Komisioni Këshillimor për dhënien e titujve vendorë të nderit për kryerjen e procedurave përkatëse dhe zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

